



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1322/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Naim Bazaj kandidat për anëtar kuvendit komunal në Drenas nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave gjatë publikimit të rezultateve të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e Naim Bazaj nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Drenas.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 24.12.2013 ka pranuar një ankesë, nëpërmjet PTK-së të parashtruar në këtë postë me datën 04.12.2013 nga Naim Bazaj kandidat për anëtar kuvendit komunal në Drenas nga rradhët e subjektit politik PDK në të cilën thekson se fshatin Baic në QV 0308e, në fshatin Terdevc QV 0323e dhe në QV 0313e në fshatin Arllat, parashtruesi i ankesës thekson se i janë keqpërdorur votat nga komisionarët e këtyre qendrave të votimit dhe se nga votat e publikuara nga KQZ-ja atij i mungojnë votat e familjarëve të tij të cilët e kanë votuar atë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për tu vërtetuar pretendimet e tilla ankimore, prandaj një ankesë e tillë është e pa bazuar dhe e pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindes andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, lidhur me ankesë e larte përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1322/2013 më datën 27.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.